

Gefördert durch



Erasmus+
Schulbildung



Kurrikula shumëgjuhëshe

Ndihmë gjatë
mësimit të gjuhës
gjermane në klasat
e gjuhëve të huaja

mig
Menschen im Gespräch



Kurrikula shumëgjuhëshe

ERASMUS+

„Menschen im Gespräch – Lehrkräftefortbildung im europäischen Kontext“

Kjo kurrikulë është konceptuar për grupe dhe klasa të mësimit të gjuhës. Ajo është menduar për gjithë shkollën dhe për këtë arsye nuk u drejtohet vetëm mësimeve dhe mësuesve të gjermanishtes si gjuhë e huaj, por në një masë të madhe edhe kujdestareve/-ëve të klasave dhe arsimtareve/-ëve të lëndëve.

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje

2

2. Kuptimi i shumëgjuhësisë

3

3. Kurrikula shumëgjuhëshe:
Kompetencat dhe Deskriptorët

5

1.

Kurrikula shumëgjuhëshe

Hyrje

Kerstin Zielosko

Gjuha është një sistem formal i kodimit dhe ka shumë funksione. Shërben për komunikim si dhe ka një funksion social, njohës dhe zhvillimor. Me fjalë të tjera, gjuha është një mjet për të menduar dhe gjeneruar njohuri, është mediumi për të mësuar.

Gjuha e arsimit ndryshon nga gjuha e përditshme apo gjuha e folur për nga shkalla e lartë e shkrimit konceptual dhe karakterizohet nga një inventar specifik i mjeteve leksikore, sintaksore dhe tekstuale (shih Gogolin & Duarte, 2016, f. 487-491; Heppt, 2016, f. 32-40). Gjuha mësohet sistematikisht dhe në mënyrë të veçantë në klasë.

Edukimi gjuhësor mund të zhvillohet jo vetëm në gjuhën amtare, por edhe në gjuhën e huaj të përzgjedhur. Qëllimi i mësimdhënësit është t'ia mundësojë nxënësit që, në një proces, ta kap përmbajtjen, të shprehet dhe të mendojë në lëndën dhe gjuhën përkatëse. Kjo do të thotë që nxënësja ose nxënësi në situatën përkatëse në gjuhën e huaj duhet të mësojë të mendojë si një atlet ose matematikan, të kapë përmbajtjen për këtë qëllim dhe të shprehet si e/i tillë. Nëse kjo arrihet me sukses, atëherë ofrohen shumë mundësi për zgjerimin e njohurive; Përvojat e mësimt ndërkulturor mund të jetësohen dhe mund të ndërtohet një qëndrim kozmopolit. Gjithashtu mund të zhvillohen edhe kompetencat në trajtimin e shumëgjuhësisë dhe diversitetit. Në këtë mënyrë krijohet mundësia për të shikuar përtej hundës tonë.

Sidomos gjatë mësimdhënies së gjuhës së huaj, planifikimi i orës mësimore kërkon një nivel të lartë të vetëdijes gjuhësore, ndjesisë gjuhësore dhe kompetencave të përgjithshme gjuhësore.

"Mësimdhënësve dhe shkollës si institucion në tërësi u nevojiten në përgjithësi njohuri sa i përket mësimt ose përvetësimit të kompetencave të gjuhës së shkruar, si dhe njohuri specifike dhe ndjeshmëri lidhur me procesin atipik të mësimt të gjuhës së shkruar, por edhe për mjetet metodike-didaktike për mbështetjen e përvetësimit të gjuhës së shkruar në kushte të vështira. Marrëdhënia midis individualitetit dhe institucionalitetit kërkon një vlerësim të ri në favor të individualitetit" (Kainhofer, 2019, f. 14). Kjo punë kërkon zgjerim të horizontit të mësimdhënësit dhe përpjekje të pandërprera për arritjen e qëllimeve që rezultojnë nga njohuritë gjithnjë e më ritje.

Kjo kurrikulë shumëgjuhëshe dëshiron të japë kontributin e saj në këtë drejtim si një mjet metodik dhe didaktik. Prandaj u drejtohet të gjithë mësimdhënësve dhe dëshiron të ndihmojë në krijimin e një atmosfere në shkollë që e sheh shumëgjuhësinë si një shans.

Literatura

Gogolin, I. & Duarte, J. (2016), *Bildungssprache*. In J. Kilian, B. Brouer & D. Lüttenberg (Hrsg.), *Handbuch Sprache in der Bildung* (S. 478-499), Berlin: Walter de Gruyter
Kainhofer, J., 2019, *Sprachliche Bildung*, PH Script, Pädagogische Hochschule Salzburg – Beiträge aus Wissenschaft und Lehre

2.

Kurrikula shumëgjuhëshe

Kompetencat dhe Deskriptorët

Joanna Barrett, Barbara Messner, Corinna Lorenzi, Verena Debiasi

Përkufizimi i "shumëgjuhësisë" është një punë jashtëzakonisht e vështirë: A janë të mjaftueshme dy gjuhë apo duhet t'i flasim më shumë gjuhë për të qenë "shumëgjuhësh"? Në çfarë niveli duhet t'i zotërojmë gjuhët? Dhe në fund: Çfarë nënkuptojmë saktësisht me fjalën "gjuhë"? Gjuhëtarët janë përpjekur në mënyrë të përsëritur ta përcaktojnë termin "shumëgjuhësi" dhe kanë arritur në përkufizime shumë të ndryshme.

Në thelb, mund të bëhet dallimi mes shumëgjuhësisë individuale dhe shoqërore. E para lidhet me aftësinë e një personi për të lëvizur në më shumë se një gjuhë; kjo e fundit, nga ana tjetër, nënkupton vende të caktuara, situata ose kontekste sociale, në të cilat përdoren disa gjuhë (krh. Allgäuer-Hackl, Jessner 2013: 111 vv). Në këtë kurrikulë, fillimisht e kemi drejtuar vëmendjen te vizualizimi dhe promovimi i shumëgjuhësisë individuale, e cila mund të çojë më tej në shumëgjuhësi në shoqëri. Shumëgjuhësia individuale nuk do të thotë zotërim i përsosur i dy ose më shumë gjuhëve, por këtu kuptohet si një term gjithëpërfshirës që nënkupton një gamë të gjerë të kompetencave gjuhësore.

Këshilli Evropian e ka bërë të qartë se të mësuarit e një gjuhe të re do të thotë shumë më tepër sesa "thjesht" mundësi e komunikimit në atë gjuhë. Shumëgjuhësia promovon rritjen e vetëdijes ndërkulturore, aftësive ndërkulturore dhe "aftësinë për të mësuar gjuhë tjera dhe për të qenë i hapur ndaj përvojave të reja kulturore". (Këshilli i Evropës 2001: 51).

Shkathtësitë shumëgjuhëshe dhe ndërkulturore zhvillohen përmes përvojës si dhe me anë të krahasimit ndërmjet gjuhëve dhe kulturave të ndryshme. Modeli i Cummins "Doppel-Eisberg-Modell" tregon se shumëgjuhësia nuk është shuma e njohurive të gjuhëve të ndryshme, por nënkupton që një person shumëgjuhësh ka edhe aftësi, që nuk janë të lidhura me një gjuhë specifike, siç janë strategjitë e mësimt të gjuhës ose aftësia për të analizuar ose prodhuar një tekst (krh. Cummins 198: 29 vv). Britta Hufeisen gjithashtu i merr parasysh këto elemente dhe disa aftësi të tjera në modelin e saj të faktorëve, i cili thotë se përvojat dhe strategjitë që zhvillohen ose përdoren kur mësojmë një gjuhë mund të zbatohen për të mësuar një gjuhë tjetër. (shih Hufeisen, Marx 2005: 148). Kjo do të thotë që kur e mësojmë një gjuhë të re, nuk duhet të fillojmë nga e para, por mund ta shfrytëzojmë përvojën e pasur që e kemi fituar nga gjuhët e tjera. Për ta aktivizuar atë thesar, megjithatë, nevojiten stimuj të jashtëm dhe pikërisht këtu mësimdhënësi luan një rol qendror.

Nëse një mësimdhënës dëshiron të promovojë vetëdijen gjuhësore dhe kulturore, së pari duhet ta posedojë një të tillë vetë. Kjo kurrikulë dëshiron ta mbështesë mësimdhënësin në këtë drejtim dhe për këtë arsye është si një kuti me vegla. Në modelin e kompetencave, mësimdhënësve u jepen sugjerime se si secila nxënëse dhe secili nxënës mund të përfitojë nga shumëgjuhësia në klasë.

2.

Kurrikula shumëgjuhëshe

Kompetencat dhe Deskriptorët

Joanna Baret, Barbara Messner, Corinna Lorenzi, Verena Debiasi

Literatura

Allgäuer-Hackl Elisabeth; Jessner, Ulrike (2013): Mehrsprachigkeitsunterricht aus mehrsprachiger Sicht. Zur Förderung des metalinguistischen Bewusstseins. Online në: [https://www.uibk.ac.at/anglistik/dyme/allgaeuer-hackl-jessner-\(2013\).pdf](https://www.uibk.ac.at/anglistik/dyme/allgaeuer-hackl-jessner-(2013).pdf) (Gusht 2018)

Cummins, Jim (1981): Bilingualism and Minority-Language Children. Toronto: Ontario Institute for Studies in Education. Online në: <https://files.eric.ed.gov/fulltext/ED215557.pdf> (Gusht 2018)

Këshilli i Evropës (2001): Gemeinsamer Europäischer Referenzrahmen für Sprachen. Berlin, Mynih: Langenscheidt. Online në: <http://student.unifr.ch/pluriling/assets/files/Referenzrahmen2001.pdf> (Gusht 2018)

Hufeisen, Britta; Marx Nicole (2005): Auf dem Wege von einer allgemeinen Mehrsprachendidaktik zu einer spezifischen DaFnE – Didaktik. Në: Fremdsprachen lehren und lernen 34, faqe 146-155.

3.

Kurrikula shumëgjuhëshe

Kompetencat dhe Deskriptorët

Kurrikula shumëgjuhëshe niset prej asaj se veprimi gjuhësor dhe komunikimi, mësimi i gjuhës dhe të folurit, veçanërisht në një kontekst ndërkulturor, mund të arrihet vetëm përmes një zhvillimi të njëkohshëm dhe paralel të aftësive vetjake, sociale dhe metodologjike. Prandaj, zhvillimi i këtyre aftësive formon bazën e kësaj kurrikule shumëgjuhëshe.

Vgl. Schwienbacher, Quartapelle, Patscheider (Hrsg.) (2017). Auf dem Weg zur sprachsensiblen Schule: Das Mehrsprachencurriculum Südtirol. Köln: Wolters Kluwer Deutschland GmbH

3. Njohuritë për shumëgjuhësinë

SAVOIR - NJOHURITË

Kompetencat

Njohja dhe përdorimi i ngjashmërive dhe ndryshimeve midis sistemeve gjuhësore

Perceptimi i modeleve botërore që bazohen në gjuhë të ndryshme

Zbatimi i njohurive për shoqërinë dhe kulturën e bashkësive të ndryshme gjuhësore

Deskriptorët

- ▲ Njohuria se shumë gjuhë fliten në të gjithë botën
- ▲ Njohuria se shpesh shumë gjuhë fliten në një vend ose një gjuhë në shumë vende
- ▲ Njohuria për rolin e gjuhëve të ndryshme përreth (gjuha e përbashkët, gjuha e shkollës, gjuha brenda familjes)
- ▲ Njohuria se gjuhët kanë marrë fjalë të huaja (taksi, kompjuter, hotel etj.), huazime (dritare, zyrë, rrugë etj) nga gjuhët e tjera
- ▲ Njohja e disa praktikave / zakoneve sociale të kulturave në mjedisin ku jetojmë
- ▲ Njohuritë për kulturat e shoqeve dhe shokëve të klasës në mjedisin ku jetojmë
- ▲ Njohuria se kulturat mund të ndikojnë tek njëra-tjetra
- ▲ Njohuria se ekzistojnë shumë sisteme fonetike
- ▲ Njohuria se ekzistojnë shumë sisteme shkrimi
- ▲ Njohja e disa familjeve gjuhësore dhe disa gjuhëve që i përkasin një familje gjuhësore
- ▲ Njohuria se kategoritë gramatikore të përdorura për të përshkruar gjuhën mund të ndryshojnë nga gjuha në gjuhë
- ▲ Njohuria se fjalët e ngjashme mund të ndryshojnë në kuptim në gjuhë të ndryshme
- ▲ Njohja e ekzistencës së situatave të ndryshme ose shumëgjuhëshe në mjedisin tuaj dhe në vende të tjera
- ▲ Njohuria se ekziston një larmi situatash kontakti midis gjuhëve dhe kulturave
- ▲ Njohja e disa stereotipeve kulturore që mund të ndikojnë në marrëdhëniet ndërkulturore dhe komunikimin ndërkulturor
- ▲ Njohja e disa stereotipeve të kulturave të tjera për kulturën vetjake
- ▲ Njohuria se dikush mund të përpiqet të përdorë ngjashmëritë gjuhësore për të lehtësuar komunikimin
- ▲ Njohuria se gjatë mësimin të gjuhëve mund të mbështetemi në ngjashmëritë (strukurore / diskursive) midis gjuhëve

3.

Trajtimi i shumëgjuhësisë

SAVOIR FAIRE - KAM AFTËSI

Kompetencat

Të veprohet me vetëdije në një situatë shumëgjuhëshe / në një kontekst shumëgjuhësh

Të krijohet një lidhje e kulturave të ndryshme me njëra-tjetrën dhe të komunikohet me sukses në një kontekst shumëgjuhësh sipas situatës

Të ndërmjetësohet në aspektin gjuhësor dhe kulturor midis kulturave të ndryshme

Të kalohet nga një gjuhë në një tjetër (Codeswitching)

Deskriptorët

- ♣ Të jenë në gjendje t'i përdorin intuitivisht në gjuhët e tjera strategjitë e leximit, dëgjimit dhe dëgjimit / shikimit të fituara në gjuhën e parë
- ♣ Të jenë në gjendje ta perceptojnë një ngjashmëri midis gjuhëve të ndryshme (tingujt, sintaksën, drejtshkrimin, leksikun, etj.)
- ♣ Të jenë në gjendje ta kuptojnë domethënien e fjalëve të një gjuhe të panjohur ose më pak të njohur duke përdorur krahasimin e gjuhës
- ♣ Të jenë në gjendje të orientohen në situata të thjeshta të komunikimit dygjuhësh
- ♣ Të jenë në gjendje të mbështeten në një gjuhë / kulturë tashmë të njohur për të zhvilluar procedura për të zbuluar dhe strukturuar një gjuhë / kulturë tjetër
- ♣ Të jenë në gjendje të njohin fjalë me origjinë të ndryshme bazuar në indicie të ndryshme gjuhësore
- ♣ Të jenë në gjendje t'i kuptojnë marrëdhëniet midis ngjashmërive dhe dallimeve midis gjuhëve përmes vëzhgimit / analizës / identifikimit
- ♣ Të jenë në gjendje të perceptojnë afërsinë e drejtpërdrejtë gjuhësore (fonetike, leksikore, gramatikore, sintaksore, etj.) Të jenë në gjendje të transferojnë me vetëdije rregullat formale dhe devijimet në gjuhë të tjera
- ♣ Të jenë në gjendje të identifikojnë strategjitë e leximit, dëgjimit dhe dëgjimit / shikimit në gjuhën e parë dhe t'i përdorin ato në gjuhë të tjera
- ♣ Të jenë në gjendje të përshtaten me partnerët bisedues kur komunikojnë në grupe dygjuhëshe / shumëgjuhëshe
- ♣ Të jenë në gjendje të fillojnë një diskurs dygjuhësh / shumëgjuhësh, për aq sa ekziston një situatë për një gjë të tillë

3. Strategjitë e mësimit të gjuhës dhe transferimit

SAVOIR APPRENDRE – MUND TË MËSOJ

Kompetencat

**Die eigenen Sprachkenntnisse
beim Erlernen weiterer Sprachen
bewusst nutzen**

Deskriptorët

- ▀ Mund të përdorim njohuritë tona paraprake gjuhësore dhe kulturore në procesin e të mësuarit
- ▀ Mund të përdorim me vetëdije strategji ndërgjuhësore të mësimit
- ▀ Mund të përdorim përvojën dhe kompetencat tona gjatë mësimit të një gjuhe të re
- ▀ Mund të përdorim njohuritë tona paraprake gjuhësore / kulturore gjatë mësimit të një gjuhe të re
- ▀ Mund të përdorim mjete ndihmëse gjuhësore (fjalorë njëgjuhësh dhe dygjuhësh, gramatika)

3. Perceptimi dhe trajtimi i diversitetit gjuhësor

SAVOIR ETRE - JAM NË GJENDJE

Kompetencat

Hapësirat vepruese të shumëgjuhësisë personale të perceptohen dhe të përdoren me vetëdije

Gjuhët dhe kulturat e tjera të trajtohen hapur dhe me interes

Të përdoret vetëdija e tij / e saj kritike ndërkulturore

Deskriptorët

- ▲ Vëmendja për gjuhët e tjera / kulturat e tjera / njerëzit e tjerë në përgjithësi
- ▲ Perceptimi i një identiteti shumëgjuhësh si i dobishëm
- ▲ Hapja ndaj gjuhëve / kulturave
- ▲ Vlerësimi për të gjitha gjuhët dhe kulturat e përfaqësuara në një klasë dhe shkollë
- ▲ Perceptimi i shenjave dhe shkronjave të tjera (thonjëza, theksi, grafitë, etj.)
- ▲ Ndjeshmëria si për dallimet ashtu edhe për ngjashmëritë midis gjuhëve / kulturave të ndryshme
- ▲ Vëmendja për aspektet formale të gjuhëve të tjera
- ▲ Kureshtja për gjuhët dhe kulturat e tjera
- ▲ Gatishmëria për të komunikuar me njerëz nga kulturat e tjera
- ▲ Besimi në analizat dhe aftësitë tuaja të vëzhgimit kur keni të bëni me gjuhë që janë pak të njohura ose të panjohura
- ▲ Gatishmëria për të kapërcyer paragjykimet dhe qëndrimet që janë penguese për të mësuar
- ▲ Gatishmëria për t'i zhdukur paragjykimet në lidhje me kulturën vetjake / kulturat e tjera